



Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Pjesëmarrje Rinore dhe Politika Rinore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10/20), nenit 48-k të Statutit të Qytetit të Shkupit" "Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 16/05, 8/10, 17/11, 18/13, 13/14, 1/15, 12/15, 19/4 dhe 21/9) dhe Vendimit për përcaktimin e nevojës për shpalljen e Thirrjes Publike për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Inicues për Konstituimin e Kuvendit të të Rinjve të Qytetit të Shkupit ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 12/21), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE **për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Inicues për Konstituimin e** **Kuvendit të të Rinjve të Qytetit të Shkupit**

I

Qyteti i Shkupit shpall Thirrje Publike për zgjedhjen e anëtarëve për formimin e Këshillit Inicues, të cilët do të jenë pjesë e iniciativës për krijimin e Këshillit Lokal Rinor të Qytetit të Shkupit.

Këshilli Inicues do të përbëhet nga 3 anëtarë.

II

Kriteret që duhet të plotësojnë të rinjtë që duan të përfshihen në Këshilli Inicues janë:

- Të jenë banorë të qytetit të Shkupit;
- Të jenë në moshën nga 15 deri në 29 vjeç;
- Të jenë kreativë dhe të aftë për punë individuale dhe ekipore.

Kritere për organizatat që duan të kandidojnë përfaqësuesin e tyre:

- Të jenë shoqata rinore;
- Organizata për të rinj;
- Forume rinore të partive politike;
- Nxënës të shkollave të mesme ose bashkësi studentore;
- Shoqata sportive;
- Shoqata kulturore-artistike;
- Forma të tjera të shoqatave rinore, shoqata formale ose shoqata joformale të të rinjve;
- Të jenë të regjistruar dhe/ose të veprojnë në territorin e qytetit të Shkupit;
- Të jenë të interesuar për zhvillimin e shoqatave rinore në nivel lokal.

III

Këshilli Inicues ka detyrat e mëposhtme:

- Të shpallë Thirrjen Publike për konstituimin e Kuvendit Lokal të të Rinjve të Qytetit të Shkupit nën përputhje me Statutin e Qytetit të Shkupit;
- Bashkëpunon me Qytetin e Shkupit në organizimin, krijimin dhe konstituimin e Kuvendit Lokal të të Rinjve të Qytetit të Shkupit;
- Këshilli Inicues formohet për shkak të konstituimit të Kuvendit Lokal të të Rinjve, dhe shpërndahet pas mbajtjes së seancës së parë konstituive të Kuvendit Lokal të të Rinjve.

IV

Aplikuesit të cilët aplikojnë si individë duhet të depozitojnë dokumentet e mëposhtme:

- Letër motivuese;
- Biografi e shkurtër – CV;
- Vërtetim se janë nxënës/studentë ose vërtetim për arsimin e përfunduar;
- Vërtetime, certifikata, diploma për kurse të kryera, trajnime, seminare dhe gara;
- Propozime me shkrim, rekomandime, deklarata të propozuesve (nëse i ka).

Subjektet juridike të cilat aplikojnë me kandidatët e tyre, duhet të depozitojnë dokumentet e mëposhtme:

- Portofoli i subjektit;
- Programi Vjetor për punën e subjektit;
- Raport për aktivitete me të rinj i subjektit për vitin e kaluar;
- Gjendja aktuale për regjistrimin e veprimtarisë së subjektit, jo më e vjetër se gjashtë muaj, e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Letër me kandidimin për anëtar të Këshillit Inicues, dhe informacione për kontakt;
- Letër e shkurtër motivuese dhe biografi e shkurtër – CV e kandidatit për anëtar, banor i Shkupit në moshën nga 15 deri në 29 vjeç.

V

Thirrja Publike zgjat deri në **10 ditë kalendarike**, nga dita e shpalljes në mjetet për informim publik dhe në ueb faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Thirrja Publike shpallet më 02.03.2022 dhe zgjat deri më 11.03.2022.

Aplikuesit të cilët plotësojnë kushtet e Thirrjes Publike, dokumentacionin e nevojshëm duhet ta depozitojnë pranë Qytetit të Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. „Ilinden“ nr.82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni deri më **11.03.2022** deri në orën **15:00**, me shënimin: **për “Thirrje Publike për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Inicues për Konstituimin e Kuvendit të të Rinjve të Qytetit të Shkupit”**.

Aplikimet depozitohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, pa shënime për personin apo subjektin i cili depoziton dokumentacionin.

Aplikimet të cilat përmbajnë të dhëna të paplota dhe dokumentacion jo të plotë, si dhe ato që nuk do të depozitohen në afatin e caktuar, nuk do të merren në shqyrtim.

Informacione shtesë mund të merren në telefonin: 3297-238 dhe 3297-320.

**QYTETI I SHKUPIT
KRYETARJA**